



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.03.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Raportimi i veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018 (*Komision përgjegjës*)

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III” (*Komision për dhënie mendimi*)

3. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe votimi në tërësi i projektligjit “Për nxitjen e punësimit” (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Edlira Bode

#### **Mungojnë:**

Damian Gjoknuri, Tom Doshi

#### **Të ftuar:**

Illir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjetikës

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Alfred Bundo – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Ardian Islami - Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

#### **HAPET MBLEDHJA**

## **Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!**

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me tri çështjet që kemi në rendin e ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III”. Si pikë të dytë është vazhdimi i shqyrtimit nën për nën dhe votimi në tërësi i projektligjit “Për nxitjen e punësimit” dhe si pikë të tretë kemi raportimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018.

Pa humbur kohë vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator i kësaj projekt marrëveshjeje është zoti Edmond Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zoti Ilir Bejtja, zëvendësministër.

Zoti Bejtja, mirë se erdhët në komision!

Zoti Agim Bregasi, drejtor, zoti Alfred Bundo, drejtor dhe zoti Ardian Islami, përgjegjës sektori.

Zoti Bejtja, do t’ju lutesha shkurtimisht për kolegët e komisionit një prezantim të kësaj projekt marrëveshjeje dhe më pas fjalën do ta marrë relatori, zoti Leka.

Fjala për ju.

## **Ilir Bejtja – Përshëndetje!**

Nëpërmjet fondeve të kësaj projekt marrëveshjeje ne mbulojmë fazën e 3-të të rehabilitimit të godinave të Qytetit Studenti në kushtet e eficiencës, një projekt i nisur në dy fazat e para për vlerësimin, rehabilitimin e 4 godinave dhe tani me 9 godina të tjera, pra në total numri i godinave është 13 dhe me një total prej rreth 2400 studentësh që përfitojnë. Pra, 580 studentë kanë përfituar nga projekti i parë, që ishte në dy faza, 4,5 milion euro dhe 2 milionë euro rreth të dyja bashkë kapin shumë prej rreth 6,5 milionë euro.

Nëpërmjet kësaj faze, e cila përfshin shumën me rreth 2,9 milionë euro, ne do të arrijmë të akomodojmë edhe rreth 1800 studentë të tjerë, të cilët do të përfitojnë nga restaurimi i këtyre godinave jo thjesht përmirësimin e kushteve të konsumit të energjisë, por edhe të kushteve të tyre të jetesës. Studentët tashmë do të jetojnë në dhoma të reja dhe në miniapartamente që fillojnë nga 2 studentë në dhomë deri në 5 studentë në një miniapartament me banjë dhe kuzhinë të përbashkët brenda këtij miniapartamenti. Pra, në përshtatje edhe të strukturës së godinave është bërë edhe zgjidhja teknike për restaurimin e tyre.

Po me këtë fond ne do të kemi mundësinë të bëjmë vlerësimin bashkë me një fond shtesë prej 155 mijë eurosh që kemi në dispozicion po nga të njëjtat burime edhe vlerësimin e 24 godinave të tjera të Qytetit Studenti nr. 1 dhe më pas rehabilitimin e tyre në të njëjtat kushte në mënyrë që brenda këtij mandati të mbarojmë rehabilitimin e të gjitha godinave në mënyrë intensive çdo vit me financime të qeverisë gjermane dhe duke mbuluar kostot lokale nga qeveria shqiptare.

Vlerësimi i eficiencës do të jetë rreth 75 kilovatorë për metër katrorë çfarë do të thotë që do të kemi edhe një kursim shumë të ndjeshëm të energjisë. Pra, në një farë mënyre ky investim e ripaguan veten nëpërmjet konsumit për rreth 6 vjet.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bejtja!

Fjalën e ka zoti Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit kryetar!

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017 për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike faza III”.

Zoti kryetar, mendoj se ia vlen të ndalemi pak te qëllimi i kësaj marrëveshjeje, sepse ka të bëjë edhe me kërkesat që studentët paraqitën në protestat e tyre, të cilat qeveria i ka marrë seriozisht dhe mendoj se pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje, si dhe pas përfundimit të rinovimit dhe riparimit sipas eficiencës energjetike të konvikteve, do të plotësohet një pjesë e mirë e kërkesave të studentëve.

Pra, qëllimi i përgjithshëm i projektit është rehabilitimi i konvikteve të Universitetit të Tiranës, duke synuar kursime të ndjeshme të energjisë, kushte jetese të përshtatshme dhe kosto të arsyeshme akomodimi. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje pritet të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit nëpërmjet krijimit të kushteve më të mira të jetesës dhe të studimit për një numër të konsiderueshëm studentësh, ulje të ndjeshme të kostove që

duhet të paguajë Bashkia e Tiranës dhe Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1., krijimin e një modeli ekonomik të caktuar, i cili mund të aplikohet në shumë projekte të tjera publike.

Përveç rehabilitimit energjetik të ndërtesave programi do të mbulojë në mënyrë të konsiderueshme masat themelore të konfortit, sipas kushteve të vendosura nga ligji i vitit 2016 për performancën e energjisë së ndërtesave, si: rinovimi i instalimeve sanitare, të pajisjeve elektrike, sistemi i ngrohjes, i ftohjes, i ventilimit, prodhimi i ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë e të tjera në mënyrë që të përmirësohet jetesa dhe mjedisi për studentët.

Objektivat e këtij projekti lidhen me komponentët e auditimit energjetik të ndërtesave, identifikimit të nevojave të rinovimit të ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre, identifikimin e masave të ndryshme të eficiencës së energjisë që mund të aplikohet, llogaritjen e kursimit të energjisë elektrike në secilën prej godinave, reduktimin i konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave, si dhe sigurimin e përmirësimit të kushteve të jetesës së studentëve. Ky projekt është në përputhje me strategjinë për zhvillimin e sektorit energjetik, ku pjesa e analizës janë ndryshimet e domosdoshme në lidhje me rritjen e sigurisë për furnizimin me energji me qëllim përmbushjen e kërkesës për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm. Me anë të kësaj marrëveshjeje palët bien dakord për akordimin e një granti nga qeveria gjermane në vlerën 3 milionë euro, financim i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet KfW-së.

Në aspektin ligjor dhe procedural jemi në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit. Unë do të doja të bëja dy pyetje për përfaqësuesit e ministrisë: së pari, cila ka qenë ecuria e deritanishme e zbatimit të marrëveshjes financiare të lidhura me qeverinë gjermane për programin e rehabilitimit të konvikteve, gjatë fazës së parë dhe të dytë? Së dyti, a është bërë një vlerësim i impaktit të tyre ekonomik dhe social?

**Agim Bregasi** – Ne jemi në fazën e parë, kur kemi zgjedhur konsulentin dhe fillojmë projektin e zbatimit për pjesën e parë.

**Alfred Bundo** - Meqë kam ndjekur fazat në zbatim, po ju them se aktualisht ka mbaruar ristrukturimi i godinave të Inxhinierisë së Ndërtimit, që janë 4 godina. Investimi ka qenë 6,2 milionë euro. Nuk është pjesë e kësaj marrëveshjeje që ne po diskutojmë sot. Sot jemi duke diskutuar për fazat nr. 1, 2 dhe 3 të ristrukturimit të Qytetit Studenti.

Në lidhje me progresin e këtij projekti, është ngritur komiteti drejtues i projektit dhe njësia e zbatimit të projektit, ndërkohë po përzgjedhim konsulentin. Jemi në fazën e shortlistimit.

**Edmond Leka-** Ju thoni se do të ketë rehabilitim të 5 konvikteve, numër 3, 14,16,17,18. Pas përfundimit të këtij investimi a do të kemi nevojë për ndërhyrje të tjera, apo konviktet plotësohen me të gjitha kushtet e nevojshme.

**Agim Bregasi** –Rehabilitimi është në total i ndërtesës. Edhe në ligj është i tillë, çdo ndërtesë që kalon 25% të nevojës për restaurim, duhet bërë me eficiencë energjie. Janë edhe 24 godina të tjera. i gjithë projekti do të përfshijë edhe një financim më tutje, rreth 18 milionë euro dhe më pas edhe 20 milionë të tjera.

**Bashkim Fino-** Në fakt, unë e kam thënë prej kohësh që grantet duhet të kalojnë me vendim qeverie, nuk ka nevojë të vijë këtu, por, gjithsesi, për nga rëndësia që ka është një nga projektligjet shumë të rëndësishme që ne po kalojmë, duke pasur parasysh se zgjidhim një pjesë të kërkesave të studentëve, të cilët kërkojnë kushte më të mira në konvikte.

Unë dua të di nëse dy fazat e para të projektit janë ezauruar, janë zgjidhur, kanë dalë me sukses, nëse granti i mëparshëm ka qenë i suksesshëm, ndërkohë që jemi duke miratuar 2,9 milionë euro për grantin e tretë. Projekti këtu në relacion thuhet se do të zgjasë 18-24 muaj. Mua më duket shumë, 18-24 muaj do të thotë 1 vit e gjysmë deri në 2 vjet, një projekt për të rehabilituar 9 godina. 2,9 milionë euro janë për rehabilitimin e 9 godinave, pra jo vetëm nga ana elektrike, por edhe të kushteve të fjetjes ose të gatimit. Tani të restaurosh 9 godina për 2 vjet mua më duket sasi e madhe kohe. Do të doja që kur të filloni disbursimin e fondeve, duhet të bëni një marrëveshje që të disbursohen shpejt, por edhe puna të fillojë sa më shpejt.

Pyetja ime ka të bëjë me sqarimin që dha zëvendësministri që brenda mandatit jo vetëm do të përfundojnë fazën e tretë, por edhe 24 godinat e tjera, me rreth 50 milionë investim. Nëse ky projekt i fazës së tretë kërkon 18-24 muaj, projekti tjetër për 24 godinat kam përshtypjen se do ta kalojë vitin 2021. Të bësh restaurimet e godinave nuk është ndonjë investim që kërkon kohë, apo që kërkon shpronësime, por kërkon kushte teknike më të përsosura, të cilat ndonjëherë ndikojnë. Të gjithë kemi restauruar shtëpitë, por sa më shpejt ta restaurosh aq më mirë është, nisur nga kjo po them që ky projekt që zgjat 18-24 muaj mua më duket pak i gjatë, do të doja që kur ju ta keni të miratuar nga parlamenti të negocioni, se kështu e thonë edhe në relacion, fondet do të fillojnë në vitin 2019, ta ulnin këtë kohë dhe t'u linin më tepër hapësirë dhe kohë 24 godinave të tjera që do të restaurohen me 50 milionë euro.

Gjithsesi, një mendim nga ju, pavarësisht se nuk ka të bëjë me projektligjin, se ne thjesht ratifikojmë shumën e parave, të cilat janë të lidhura me investimin dhe mirëqenien e studentëve.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Fjala për zotin Bejtja.

**Illir Bejtja** – Projekti është i tillë për shkak të aspektit teknik të zbatimit të tij. Kemi një zgjatje të periudhës, kemi kërkuar 30 muaj, nga 24 muaj për fazën e parë, në mënyrë që të përmbyllen të tria fazat 9,2 milionë euro për këto 9 godina.

Lidhur me faktin që nuk ndërtojmë godina të reja, Qyteti Studentit do të vazhdojë të bujtë studentë ndërkohë, prandaj edhe procesi nuk është një proces normal që ne të fillojmë në front me çdo lloj ndërtimi. Ky grafik nuk është përcaktuar nga ministria jonë, por është bërë nga Drejtoria e Qytetit Studenti në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Këta e kanë përcaktuar si kalendarin optimal dhe më të shpejtë të mundshëm, ndërkohë ne do të mbyllim marrëveshjet për auditimin e Qytetit Studenti brenda fondit të parë dhe do të fillojmë menjëherë nisjen e vlerësimit për rehabilitimin e godinave të tjera. Pra, nëse i referohem këtij mandati, i referohem faktit që i gjithë projekti do të jetë funksional, mund të zgjasë edhe më tepër se periudha 2020-2021, por këtë do ta shikojmë në mënyrë teknike kur të vijë projekti i miratuar edhe nga Drejtoria e Qytetit Studentit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Zonja Bushka ka një pyetje.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është një grant i qeverisë gjermane, i cili i ka dhënë rezultatet në përmirësimin e kushteve të jetesës në konviktet e studentëve. Shoh që, përveç çështjeve që lidhen me eficiencën e përdorimit të energjisë në godina, që është edhe koncepti pse është vendosur ky grant, jo vetëm pse do të kursejë para, por do të krijojë kushte më të përshtatshme për një jetë më të shëndetshme, kemi edhe disa ndërhyrje të tjera që bëhen po nëpërmjet grantit, që janë: rinovimi i instalimeve sanitare, rinovimi i pajisjeve elektrike, sistemi i ngrohjes, ftohjes, ventilimi, prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë, lavanderi me operim monedhash, dhoma të përbashkëta studimi e të tjera. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme, sa u takon kushteve më të mira të jetesës së studentëve, por sa u takon pajisjeve të mjediseve qofshin dhoma a mjedise të përbashkëta, janë pjesë e këtij granti, apo pjesë që financohet nga buxheti i shtetit? Nëse është e tillë, a është e parashikuar, sepse do të donim të kishim një projekt të përfunduar në total, që të mos ngelemi nesër, që me anë të grantit bëjmë një ndërhyrje dhe më pas është e nevojshme të plotësohen nga buxheti i shtetit, pikërisht për të mos humbur kohën kur me të drejtë e ngre si shqetësim kolegu Fino.

Faleminderit!

**Illir Bejtja** – Sa i takon pjesës së furniturave, nuk janë pjesë e këtij projekti, domethënë i ka Drejtoria e Qytetit të Studentëve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ato janë ndërmarrje Sh.a.

Normal që godinat e reja nuk do të ngelen bosh e me krevate të vjetër. Bëhet fjalë për godina me kushte optimale, ku studentët do të hyjnë rishtazi për herë të parë dhe jo në të njëjtët shtretër apo mobilie që kanë qenë më parë.

Ashtu siç është shkruar këtu, ne furnizojmë me pajisjet sanitare, uji i ngrohtë, sepse edhe këto janë pjesë e konceptit të eficiencës në ndërtim, performancës energjetike në ndërtim, edhe për ujin e ngrohtë janë parashikuar panele diellore e të tjera me radhë. Pra, pjesa e furniturës nuk është pjesë e këtij financimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kam këtë informacion.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bejtja!

Fjala për zonjën Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk do të pyes gjatë, pasi e kemi diskutuar edhe në Komisionin për Politikën e Jashtme, por një nga shqetësimet që ka ngritur administrata e Qytetit Studenti është lidhur me kostot që kanë për shpenzime energjie, sepse tarifat trajtohen si biznes. Nga një anë ju flisni për eficiencë të energjisë në konvikte, flisni për rritje të eficiencës, ulje të kostove dhe përmirësim të kushteve, nga ana tjetër, do të doja të dija nëse mundet të zgjidhet edhe ky shqetësim që është ngritur nga drejtuesit e Drejtorisë së Qytetit Studentit. Besoj se jeni në dijeni të shqetësimit të tyre, dhe me këtë marrëveshje, me këtë investim, a ulen kostot e menaxhimit të asaj qendre?

**Ilir Bejtja** – E thashë edhe më parë, ata do të paguajnë më pak energji në mënyrë të ndjeshme, pra 75 kilovatorë për metër katror banesë. Kam parasysh që në Qytetin Studenti konsumi i energjisë duhet të jetë shumë modest, pasi ata nuk përdorin energji sikur përdorin familjet, për vetë kuptimin e jetës së përbashkët që bëjnë. Kështu që mendoj se energjia nuk është konsumi i tyre kryesor, në formimin tim, mendoj që ka të tjerë konsume shumë më të rëndësishme se energjia. Është e rëndësishme dhe jetike, sepse jep dritën, ndez televizorin, i jep rrymë kompjuterit që ata të punojnë, por nuk është kjo kryesorja. Ndërkohë, flasim për konsume që nuk janë pjesë e eficiencës, pajisjet që përdorim në shtëpi nuk kanë lidhje me eficiencën, flasim për eliminimin e ujërave termike, izolimin, ujin e ngrohtë, pra konsume komunitare të përbashkëta që përballohen nga ndërmarrja e Qytetit Studenti dhe ky konsum parashikohet të ulet në 75 kilovatorë për metër katror, që do të thotë se me këto ritme, bazuar në konsumin që ata kanë sot, brenda 6 vjetëve këto para do të rikthehen. Do t'i takojë qeverisë

të vendosë se ku do t'i rialokojë, në infrastrukturë studentore apo diku tjetër, në funksion të nevojave që do të ketë. Pra, nuk janë kredi dhe nuk do t'i kthehen qeverisë gjermane.

Ndërkaq, ne nuk kemi çmime sektoriale. Kjo varet nga vendi ku ata lidhen me rrjetin e tensionit. Nuk janë familjarë, por janë ndërmarrje subjekt dhe paguhet si të tilla.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bejtja!

Ka pyetje nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

Ka diskutime?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Ky është një projektligj shumë i mirë dhe interesant, pavarësisht pyetjeve që po bëjnë deputetët, që kërkojnë angazhimin serioz të qeverisë dhe të Bashkisë së Tiranës. Kjo tregon që kjo qeveri është serioze në ato që thotë, po të kemi parasysh edhe protestën e studentëve.

Një prej shumë kërkesave që bëjnë studentët ishte për mirëqenien e jetesës në konvikte. Ndërkohë që dy fazat janë zgjidhur, ne sot po miratojmë fazën e tretë.

Pavarësisht se në projektligj ne thjesht ratifikojmë këtë grant prej rreth 3 milionë eurosh, gjithsesi, pyetjet e deputetëve ishin vërtet thelbësore, sepse kanë të bëjnë me mirëqenien e studentëve, për të menduar se si do të realizohet një investim i tillë.

Ky investim rrit mirëqenien e studentëve. Nuk do të ketë më diferenca të jetesës së studentëve, që vijnë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë këtu në Tiranë, pra do të kemi kushte pothuajse të barabarta me ato në shtëpitë e tyre. Pse jo (këtë e them me bindje), këto kushte mund të jenë edhe më të mira se në familjet e tyre. Ky është një detyrim (këtë e kam për publikun, nuk e kam për deputetët) dhe një angazhim i marrë prej kohësh nga qeveria dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, i cili ka ndërmarrë edhe një nismë shumë interesante për ta pastruar Qytetin Studenti nga njerëzit që kanë marrë shtëpi me qira, që janë jashtë strukturës për studentët, si dhe të investimit që bëjnë.

Të gjitha këto pyetje që bëjnë ne, zoti kryetar, kanë të bëjnë më shumë me efektivitetin e këtij projektligji sesa me ngritjen e duarve për 3 milionë euro, që do të kalojnë si grant për të vazhduar fazën e tretë.

Sinqerisht, nuk do të ishte keq që në këtë panel të sotëm të kishte edhe përfaqësues të Bashkisë së Tiranës, të cilët kanë projekte më të detajuara, më teknike, të punës.

Në relacion thuhet se projekti zgjat 18-24 muaj (mua më duket kohë e gjatë), mbase Bashkia e Tiranës do të na jepte një informacion më të detajuar, që ky projekt apo kjo kohëzgjatje mund të jetë shumë herë më e shkurtër (ka mundësi të jetë më e shkurtër) dhe me një cilësi të mirë, kuptohet, për t'u ardhur sa më shpejt në ndihmë studentëve.



Zëvendësministri tha se mund të ketë probleme, se ata janë bujtës dhe rrinë atje... Ka kohë të mjaftueshëm. 2-3 muajt e beharit kur qytetet janë bosh, mund të punohet me intensitet më të lartë nga firmat përkatëse apo nga Bashkia e Tiranës.

Kështu që ne duhet të marrim një informacion teknik, na bën mirë edhe si deputetë, sepse, në fund të fundit, jemi politikanë dhe nuk jemi këtu thjesht për të ngritur dorën për 3 milionë euro nga Bashkia e Tiranës. Megjithatë unë di shumë gjëra për këtë projekt, këtë informacion duhet ta kenë deputetët këtu, sepse në fund të fundit, jemi përballë një realiteti, studentët në të gjitha kërkesat që ngritën, një ndër to kishin dhe mirëqenien e konvikteve dhe kjo gjë po bëhet realitet. Jam shumë i bindur dhe kam shumë besim te Bashkia e Tiranës, por duhet të ketë një kontroll të vazhdueshëm tek investimi që ata bëjnë. Unë jam deputet i vjetër kam miratuar dhe kam ngritur dorën shumë herë për fonde pafund për Qytetin Studenti, por problemi është se këto fonde duhet të marrin fund në sensin e efektivitetit të investimit që bëhet, ai të jetë i saktë, i drejtë dhe të mirëmbahet nga drejtoritë përkatëse, që të jemi korrektë dhe të mos na kërkojnë fonde të tjera. Ja ku jemi sot për të treguar se ky investim do të rrisë mirëqenien e studentëve të të gjithë Shqipërisë këtu në Tiranë. Prandaj do të kërkoja që ky informacion, i cili ka të bëjë thjesht me një ratifikim të na vijë më i detajuar për çështje teknike, apo për çështjet e realizimit të investimit dhe të këtyre godinave. Unë këmbëngul, përsëri zoti kryetar në uljen e projektit dhe jo në kohëzgjatjen prej një viti e gjysmë deri në dy vjet, por mundësisht të bëhet brenda këtij viti, sepse edhe rimbursimet do të bëhen brenda vitit 2019. Pastaj të kemi mundësi për investimin që tha zëvendësministri që është rreth 50 milionë euro të tjera, që do të trajtohen edhe 24 godina të tjera për ta trajtuar siç tha zotëria politikisht. Më pëlqeu jashtëzakonisht shumë dhe i qëndroj fort që brenda mandatit tonë deri në vitin 2021 të restaurohen, të rregullohen të gjitha godinat, jo vetëm këto 9 godinat, të cilat me këtë ligj që kalojmë sot do të jenë patjetër efektive, kërkoj që të jetë më e shpejtë. Kërkoj një informacion bashkëlidhur me Bashkinë e Tiranës, që kur të vijmë në seancën plenare për diskutime të mos bëhet thjesht për të ngritur dorën për 3 milionëshin, por të diskutohet për të marrë një përgjigje politike shumë të rëndësishme nga maxhoranca, nga kjo qeveri dhe nga Bashkia e Tiranës për të gjithë studentët e Shqipërisë pa dallim që jetojnë në Qytetin Studenti. Për këtë arsye, ndoshta u zgjata, por është një diskutim që më pëlqen dhe është një çështje për të treguar seriozitetin e qeverisë dhe të Bashkisë së Tiranës.

**Ulsi Manja**- Faleminderit!

Zoti Hyeseni e ka kërkuar fjalën për diskutim.

**Alket Hyseni** - Faleminderit!

Unë kam një kënaqësi trefish për të diskutuar sot për këtë projektligj. Kam pasur nderin, por edhe përgjegjësinë të jem kryetar i Këshillit Mbikëqyrës për disa vite në rezidencën studentore, një ndërmarrje të cilën e trashëguam në një gjendje mizerabël, një ndërmarrje të cilën e trashëguam nga administratorë, të cilët vetëm administrimin nuk kishin pasur qëllim, por vetëm gërryerjen e asaj ndërmarrjeje dhe dorëzimin me ndërrimin e pushtetit në gjendjen më të keqe të mundshme nga pikëpamja financiare.

Zëri kryesor problematik që ka pasur ajo ndërmarrje, po kontrolloja *e-mail*-et, i cili mbulonte mbi 25% të detyrimeve afatshkurtra, detyrimet vjetore ishte ai i energjisë elektrike, sepse në ato kushte mjerane ku jetonin studentët, në ato dhoma ku izolimi ishte inegzistent, ku lagështira ishte në kushte ekstreme, ku dyert dhe dritaret ishin që kur ishin ndërtuar godinat nga ish-regjimi i Enver Hoxhës, ku uji më shumë mungonte sesa vinte. Me të drejtë që nuk përballohej ngrohja as me një as me dy priza nga studentët. Unë kam shkuar vetë në shumë ambiente dhe e kam konstatuar gjendjen. Atëherë, të shqetësuar së bashku me drejtorinë, me ekzekutivin e asaj ndërmarrje, në atë kohë ishte në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe me ministrin e Ekonomisë së asaj kohe zotin Ahmetaj u vumë në lëvizje me porositi të veçantë të Kryeministrit për të siguruar mundësinë e financimit dhe për të bërë projektin përkatës. Sot është momenti për të konstatuar me kënaqësi, vërtet ka kaluar shumë kohë, vërtetë kanë kaluar gati 5 vjet nga kjo iniciativë, por tashmë ky projekt ka filluar ekzekutimin. Jemi në fazën e parë. Është një projekt shumë i vështirë nga pikëpamja teknike dhe këtu dua të sqaroj zotin Fino, me atë informacion që kam pasur atëherë, është një projekt që do të zbatohet gradualisht, nuk është një projekt masiv, ku të lejon mundësinë që në kantierin e punës të punohet nga mëngjesi në darkë apo me orare të zgjatura gjatë natës, por alternohet mundësia e akomodimit të studentëve me mundësinë e punës paralelisht me ta. Për këtë arsye nuk është e mundur të evancohet shpejt në kohë. Prandaj edhe fazat e mëparshme kanë pasur zgjatjen e tyre. E rëndësishme është të nderuar kolegë, që sot jemi në një fazë ku përtej asaj që thashë si ish-drejtuës i asaj ndërmarrjeje, por duke folur si një pedagog dhe si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në dy aspektet e tjera të kënaqësisë së miratimit të këtij ligji sot, jemi para marrjes së një premtimi të madh ndaj studentëve tanë, një premtim i cili është bazik, por për të bërë dallimin mes atyre që të njëjtën ndërmarrje e masakruan dhe mes nesh që brenda një 5-vjeçari këtë ndërmarrje po arrijmë ta kthejmë në një qytezë të vërtetë studentore në një kampus, universitar ku është fare e dukshme sesi ishte dhe si është. Deri para 5 vjetësh, të nderuar kolegë, të mos harrojmë... Unë sot do të kisha kënaqësi të kisha kolegët e opozitës, por ata zgjodhën të lënë mandatet për këto arsye, ngaqë nuk kanë më moral e fytyrë t'u dalin përpara shqiptarëve, sepse do të mjaftonte vetëm ky rast, që t'u tregoja atyre se nga një

ndërmarrje, ku vetëm ish-deputetë dhe ish-drejtuës të lartë të pushtetit kishin krijuar biznese brenda kësaj qendre studentore, që të nxirrnin fitime të majme për veten dhe familjet e tyre, duke vjedhur edhe energjinë elektrike.

Mund t'ju them se zëri kryesor i borxhit ishte pikërisht borxhi i prapambetur i krijuar nga bizneset e pushtetit, apo të lidhura me pushtetin, të cilët nëpër vite e kishin shfrytëzuar me qira dhe nuk kishin paguar energjinë elektrike, apo në raste të caktuara edhe biznese të cilat, në kundërshtim me ligjin, kishin arritur të bënin privatizimin, e që furnizoheshin me energji nga qendra studentore, pa pasur një kontratë të drejtpërdrejt me operatorin. Se mbase u zgjata pak.

Ne na vjen keq që ata e lanë mandatin, sepse do të donim që të vazhdonte të mbetej si opozitë, sado e keqe që të ishte, sepse më mirë një opozitë e keqe se sa pa opozitë fare. fatmirësisht, duke qenë se nuk është votuar individ, por listat, besoj se do të kemi edhe kolegë nga e djathta, të cilët do t'i mbushin radhët e opozitës, e të vijnë të debatojnë me ne për këto punë të mira që ne bëjmë qoftë edhe në këtë aspekt. janë punë të mira jo thjesht pse përmbushin premtimet ndaj studentëve, në kuadër të paktit me universitetin, që në fakt studentët nuk e kërkuan., por ishte qeveria ajo që u tha se përtej tetë kërkesave të tyre, një nga kërkesat ekstra do të ishte edhe gjendja e konvikteve. Ne nuk e kemi mbajtur vetëm te qendra studentore, por e kemi mbajtur te rezidenca studentore nr 1, në Qytet Studenti, por edhe te ndërmarrja tjetër, te inxhinieria, siç e njih populli. Po kështu e kemi mbajtur edhe në universitetin e Gjirokastrës dhe kudo ku ka konvikte, si në Korçë, etj. Ndryshimi është i dukshëm. Ndoshta nuk është akoma perfekt, ndoshta nuk është ajo që ne kemi pasur si vizion, por do të bëhen të gjitha si ky projekt. Prandaj, unë ju ftoj që, pa ekuivoqe, ta miratojmë këtë projekt, ta bëjmë presionin tonë, që të ecim mirë, mundësisht sa më shpejt, ta mbështesim këtë ministri. Njëkohësisht të falënderojmë pa masë mbështetësit dhe financuesit e këtij projekti, të cilët jo vetëm për këtë qendër, por janë nga financuesit kryesorë të shumë projekteve në Shqipëri, madje edhe të një projekti më të gjerë se kaq, në fushën e eficiencës në energjinë elektrike. Këtu gjej rastin që, si deputet i Sarandës, të falënderoj financuesit për përfshirjen në një nga këto projekte, edhe të gjimnazit historik “Hoxha Tahsin” të Sarandës, me një vlerë të konsiderueshme, një gjimnaz i parestauruar që nga ndërtimi i tij. Falë këtyre investimeve, këtyre donatorëve dhe i politikave të qarta të eficiencës së energjisë elektrike, nga qeveria aktuale, bëhet e mundur të kemi ambiente dinjitoze e me eficiencë maksimale të konsumit të energjisë elektrike.

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka diskutime të tjera, sepse, në fund të fundit, kjo marrëveshje, që ta përmbledhim me tri fjalë se çfarë përfitohet nga kjo marrëveshje, nga financimi i kësaj faze, e që ta dinë studentët e Qytetit Studenti: rehabilitim energjetik i ndërtesave, rinovim i instalimeve sanitare, rinovim i pajisjeve elektrike, sistemi i ngrohjes dhe i ftohjes, ventilimi, prodhimi i ujit të ngrohtë sanitar, rritja e masave të sigurisë në godina, lavanderi me operim monedhash, dhoma të përbashkëta studimi, si dhe rehabilitimi i mjedisit përreth godinave.

Pra, kjo është marrëveshja. Praktikisht, me përjashtim të furniturave të brendshme të dhomave, që janë financim i bashkisë së Tiranës, më të gjitha të tjerat i bie që praktikisht të bëhet godinë e re, nga e para.

Këtu gjejmë rastin të falënderojmë edhe qeverinë gjermane në lidhje me financimin e këtij projekti me Qytetin Studenti. Shpresojmë dhe besojmë se ministria përkatëse dhe qeveria shqiptare të lidhin marrëveshje edhe për rehabilitimin e godinave të tjera të kampuseve të tjera universitare që ka Shqipëria.

Këto marrëveshje duhet të shtrihen në të gjitha kampusit e tjera universitare që ka Shqipëria: Shkodër, Tiranë, Elbasan, Korçë, Vlorë, Durrës, gjithkund ku është përqendruar rinia studentore shqiptare.

Edhe një herë faleminderit!

Tani le ta hedhim në votim.

Kush është dakord me marrëveshjen?

Pro? Kundër s'ka? Abstenim s'ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetik, faza e tretë”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Hedhim në votim në tërësi marrëveshjen.

Kush është pro me marrëveshjen në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi marrëveshja.

Relatori të bëjë gati dokumentacionin përgjegjës dhe më pas t'i kalojë seancës plenare për votim.

Faleminderit, zoti Bejtja!

Faleminderit, kolegë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.03.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për nxitjen e punësimit”

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Edlira Bode

**Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Tom Doshi

**Të ftuar:**

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Genta Prodani – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me çështjen tjetër të rendit e ditës, vazhdimin e shqyrtimit nën për nen dhe votimin në tërësi të projektligjit “Për nxitjen e punësimit”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegja Elena Xhina.

Të ftuar nga Ministria e Financave kemi zonjën Dajna Sorensen, zëvendësministre e Financave dhe stafi që e shoqëron.

Siç jeni në dijeni, kemi lënë të pambyllura katër nene, nenet 14, 15, 16 dhe 21 të projektligjit. Relatorja dhe përfaqësuesit e ministrisë kanë punuar gjatë javës që shkoi me riformulimin e këtyre neneve.

Zonja Xhina, ju lutem, na flisni shkurtimisht për dakodësinë që keni pasur për këto nene dhe për riformulimet përkatëse, të cilat kolegët i kanë mbi tavolinë.

Vazhdojmë me nenin 14.

**Elena Xhina** – Faleminderit zoti kryetar!

Pas konsultimeve që patëm me përfaqësuesit e ministrisë dhe me Departamentin e Administratës Publike, arritëm në një marrëveshje që në këtë projektligj duhen vënë kushtet se si do të funksionojnë institucionet dhe përgjegjësitë kryesore të tyre. Në këto kushte neni 14 është riformuluar. Kolegët e kanë mbi tryezë, nëse është e nevojshme, mund ta lexoj.

**Ulsi Manja** – Jo nuk është e nevojshme.

Zonja Sorensen, a jeni dakord me riformulimin e dakordësuar nga relatorja?

**Dajna Sorensen** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim nenin 14.

Kush është pro nenit 14 me riformulimin e bërë nga relatorja dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15, “Këshilli konsultativ për punësimin”.

**Elena Xhina** – Duke pasur parasysh që të mos krijohen mbivendosje me Kodin e Punës, është bërë riformulimi i nenit 15, të cilin kolegët e kanë mbi tryezë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Zonja Sorensen, a jeni dakord?

**Dajna Sorensen** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim nenin 15 me riformulimin që është bërë. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16 sugjerohet të hiqet.

**Elena Xhina** – Me konsultimin që patëm me përfaqësuesit e ministrisë u pa e nevojshme që neni 16 të hiqet, sepse kjo dispozitë dhe institucioni që ishte parashikuar në të nuk sillte risi apo prurje të reja në këtë fushë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Zonja Sorensen, a jeni dakord?

**Dajna Sorensen** – Dakord.

**Ulsi Manja** – E hedhim në votim. Kush është pro për heqjen e nenit 16? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet heqja e nenit 16.

Kalojmë te neni 21.

Fjalën e ka zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, lidhur me nenin 21 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka paraqitur një rekomandim komisionit përkatës dhe Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, por edhe komisionit përgjegjës, i cili sjell në vëmendjen tonë përqasjen e këtij neni me ligjin “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me konventën që kemi ratifikuar “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Ju po thoni shqetësimin e një institucioni. Dakord, por t’i lëmë kohë relatores dhe zëvendësministres që të bëjnë koordinimin e këtij neni, sepse mund ta kenë bërë këtë që thua ti. Përse po ua harxhon kohën?

**Vasilika Hysi** – Më është drejtuar një letër.

**Bashkim Fino** – Të është drejtuar ty?

**Vasilika Hysi** – Po.

**Bashkim Fino** – Ju jeni individ, moj zonjë, këtu jemi në komision. Ai duhet t’ia drejtojë komisionit dhe jo ty. Unë refuzoj të të dëgjoj për këtë gjë.

**Vasilika Hysi** – Dakord. Më është drejtuar si kryetare e komisionit ....

**Bashkim Fino** – Kur ka letra personale, mund t’i mbani personale...

**Ulsi Manja** – Të lutem, zoti Fino.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta mbylлим se nuk është ndonjë gjë. Fjalën ia dhashë unë zonjës Hysi.

**Vasilika Hysi** – Letra është zyrtare dhe i është dërguar çdo deputeti që është anëtar i komisionit...



**Bashkim Fino** – Nuk e kemi ne.

**Vasilika Hysi** – Dakord. Prandaj duhet kjo transparencë që po bëj unë.

E dyta, më është drejtuar mua nën cilësinë e kryetares së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.

E treta, i është drejtuar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë. Unë po e them se cilat janë shqetësimet dhe pa dyshim që pastaj fjalën e ka relatorja. Por tërheq vëmendjen që gjatë diskutimit dhe miratimit të nenit 21 të këtij projektligji, do të kemi parasysh ligjin “Për azil në Republikën e Shqipërisë”, konventën “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”, si dhe çështjet që kam ngritur në diskutim, lidhur me rritjen e përqindjes së personave që do të punësohen në raport me numrin e punonjësve dhe për pagën minimale. Pra a do të paguhet 50% e pagës apo punëmarrësi do të derdhë pagën e plotë minimale? Ne kemi pasur një mendim ndryshe, por komisioneri thotë që ky ligj nuk nxit dhe nuk heq barrierat për punësimin e personave me aftësi të kufizuar...

**Bashkim Fino** – Është mendimi i tij.

**Ulsi Manja** – Të lutem, zoti Fino.

**Vasilika Hysi** – Po, por ai është institucion i krijuar me ligj, është institucion i pavarur, raporton në Komisionin e Ligjeve, raporton në Kuvendin e Shqipërisë dhe ne duhet të kemi një përgjigje sot.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zonja Hysi!

Zonja Xhina, jemi te neni 21 dhe unë dua të di se çfarë keni dakordësuar me Ministrinë e Financave?

**Elena Xhina** – Faleminderit!

Atëherë, lidhur me shqetësimet që ngriti zonja Vasilika, ne i kemi ngritur edhe herën e kaluar në komision dhe i kemi diskutuar me kolegët, gjithashtu edhe me përfaqësuesit e ministrisë. Problematikat që ngritën zonja Hysi dhe kolegët e komisionit u përkasin pikave 1 dhe 2 të nenit 21 dhe mendojmë se komisioni përgjegjës duhet të vendosë konkretisht se cili do të jetë raporti i punësimit të personave me aftësi të kufizuar, si dhe masat e sanksionit nëse ata nuk e zbatojnë dispozitën. Ne kemi marrë përsipër të bëjmë vetëm riformimin e pikave 3, 4 dhe 5, ndërsa për sa u përket pikave 1 dhe 2 i rekomandojmë komisionit përgjegjës që t'i vlerësojnë këto parashikime, me qëllim sigurimin e një balance të duhur proporcionale...

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, a ka mundësi që të mbani qetësi, sepse kur ju folët, ne ju dëgjuam!

**Elena Xhina** – Pra, ne kemi rënë dakord me Ministrinë e Financave që të riformulojmë pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 21. Ndërsa, për sa u përket pikave 1 dhe 2, që përkojnë

edhe me shqetësimet që u ngritën në këtë komision, ne kemi marrë përsipër që t'i rekomandojmë komisionit përgjegjës të shikojë edhe një herë balancën e duhur proporcionale ndërmjet detyrimit, që parashikohet të vendoset ndaj punëdhënësve, me qëllim që të arrihet punësimi i personave me aftësi të kufizuar dhe nxitja efektive e këtyre personave. Pra, komisioni përgjegjës, sepse kjo lidhet drejtpërdrejt me punësimin dhe me nxitjen e tij, e ka për detyrë që të vendosë raportin e duhur dhe masat që do të marrë në rast se ky raport nuk do të zbatohet.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Atëherë, neni 21 do të hidhet në votim. Pikat 1 dhe 2 do të mbeten kështu siç janë, me sugjerimin përkatës për komisionin përgjegjës, kurse për pikat 3, 4 dhe 5 ka një riformulim nga relatorja të dakordësuar edhe me Ministrinë e Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, nuk mund të bëni asnjë lloj rekomandimi apo sugjerimi! Në raportin që do t'i përcillet komisionit përgjegjës, për pikat 1 dhe 2 do t'u sugjerohet që të mbajnë në konsideratë ato që tha relatorja. Pikat 3, 4 dhe 5 janë riformuluar nga relatorja dhe janë dakordësuar nga Ministria e Financave.

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi “Për nxitjen e punësimit”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Unë do t'u kërkoja relatores dhe këshilltarëve të komisioni, të cilët janë marrë me projektligjin “Për nxitjen e punësimit”, që në raportin që do t'i përcillet komisionit përgjegjës të reflektojnë të gjitha sugjerimet e bëra në Komisionin e Ligjeve.

Faleminderit, zonja Sorensen, për prezencën tuaj në komision!

Ditë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.03.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Raportimi i veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Edlira Bode

**Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Tom Doshi

**Të ftuar:** Besnik Dervishi – Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Besa Velaj- Këshilltare e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Eneida Bardhoshi - Inspektore pranë Drejtorisë së të Drejtës për Informim

Redi Skenderaj - Specialist i marrëdhënieve me publikun

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, me raportimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

Personale për vitin 2018. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Elena Xhina.

Sot në komision kemi prezent Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zotin Besnik Dervishi, si dhe stafin e tij.

Zoti Dervishi, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Është një raportim vjetor, që e bëjnë të gjitha institucionet e pavarura dhe të krijuara me ligj. Kolegët e mi të komisionit janë njohur me raportin e veprimtarisë për vitin 2018, ndaj, zoti Dervishi, do t'ju lutesha shkurtimisht të fokusoheni në raportimin tuaj në zbatimin e detyrave të lëna në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për institucionin që ju drejtoni për vitin 2018. Më pas fjala është për relatoren, e cila ka hartuar edhe një rezolutë për veprimtarinë e Komisionerit. Gjithsesi rezoluta nuk do të miratohet sot, por në një mbledhje të ardhshme të komisionit.

Fjala është për ju.

**Besnik Dervishi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Hartimi i raportit për vitin 2018 bazohet në analizën e performancës institucionale të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me monitorimin dhe zbatimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Të drejtat e parashikuara në ligjet e sipërcituara janë pjesë e aktit më të lartë të vendit tonë, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenet 23 dhe 35 të saj.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit mbështetet në zbatimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017”, si dhe detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare.

Për sa i përket të drejtës së informimit gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën lidhur me zbatimin dhe monitorimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji kryhet nëpërmjet monitorimit të elementeve të ndryshme të tij si, për shembull: numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore, si dhe vendimmarrja e Komisionerit.

Gjatë vitit 2018 pranë zyrës së Komisionerit janë depozituar 820 ankesa, prej të cilave 622 janë zgjidhur pas ndërhyrjes së Komisionerit apo me ndërmjetësimin e zyrës së

Komisionerit. Për 37 prej tyre Komisioneri është shprehur me vendim, ndërsa 116 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit të ligjit, 9 ankesa kanë rezultuar jashtë afatit dhe 17 ankesa kanë rezultuar të paplota.

Zyra e Komisionerit ka realizuar 93 hetime administrative.

Gjithashtu, ka pasur komunikim me 195 autoritete publike gjatë vitit 2018. Janë zhvilluar 29 seanca dëgjimore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Nga monitorimi i autoriteteve publike ka rezultuar se 219 autoritete publike e kanë tashmë të konsoliduar programin e transparencës, 331 autoritete publike kanë një koordinator për të drejtën e informimit dhe 178 autoritete publike e kanë funksional regjistrin e kërkesave dhe të përgjigjeve.

Natyrisht, nuk jemi ende në maksimumin e mundshëm të kapaciteteve, sepse të gjitha autoritete publike duhet të kenë programin e transparencës, koordinatorin dhe një regjistër funksional, por unë besoj se ka një hop cilësor në 2 vjetët e fundit.

Më mirë nga të gjitha paraqiten institucionet e pavarura, sepse strukturat e tyre mbeten më të konsoliduara dhe koordinatorët janë të njëjtët që janë emëruar që në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit.

Një vëmendje e veçantë gjatë vitit 2018 i është kushtuar pushtetit vendor. Zyra e Komisionerit thekson se niveli i transparencës së bashkive shënon përmirësime. Mjafton të përmendim një shifër: nga 7244 që është numri i kërkesave të paraqitura pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, vetëm 367 prej tyre rezultojnë të refuzuara. Është i rëndësishëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore fakti që Komisioneri ka përgatitur programin e meritë-transparencës të dedikuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, i cili është programi më i plotë dhe më i kompletuar. Realizimi i tij do të bëjë që transparenca e njësive të vetëqeverisjes vendore, zbatimi i këtij programi transparenca do të bëjë që transparenca në to do të arrijë në nivele maksimale.

A ka problematika? Natyrisht, ka. Shpeshherë programet e transparencës nuk janë të përditësuara dhe mungon një pjesë e dokumenteve, që duhet të jenë të publikuara sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit. Një nga informacionet që vijon të mos bëhet publik është ai që lidhet me buxhetin, disa herë me prokurimet, por në rastet më të shpeshta, kur ka të bëjë me raportet e auditimit. Konstatohet se koordinatorët për të drejtën e informimit janë në nivel specialistësh dhe kanë akses të limituar në strukturat e tjera. Kjo sjell vështirësi në vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar duke respektuar afatin 10-ditor.

Gjithashtu, janë konstatuar raste kur kërkesat për informacion nuk kalojnë te koordinatori, por delegohen në struktura të tjera duke u trajtuar njësoj si shkresat e zakonshme, duke humbur në morinë e praktikave administrative.

Gjithashtu, jo të gjithë koordinatorët (për shkak të ndërrimeve të shpeshta që pësojnë në administratë), gëzojnë njohuritë e mjaftueshme për kuadrin ligjor, gjë që sjell që zbatimi i këtij ligji të mos jetë në nivelin e duhur.

Një problematikë e fundit që ka rezultuar në disa sektorë, është mosdhënia e informacionit publik, duke keqinterpretuar parimin e konfidentalitetit dhe kufizimet e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili është shumë i qartë dhe i saktë edhe për sa i përket dokumentacionit të klasifikuar sekret shtetëror.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë vitit 2018 janë paraqitur gjithsej 245 ankesa nga të cilat 170 kanë rezultuar të mbështetura në objektin e ligjit.

Janë realizuar 190 inspektive kryesisht në fushat e arsimit, të shëndetësisë, në sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura; sektorin e vlerësimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme; në sektorin e shërbimit postar. Në mbyllje të procedurave hetimore zyra e Komisionerit ka dhënë 30 vendime, të cilat korrespondojnë me 61 sanksione administrative të vendosura.

Janë trajtuar 14 praktika për autorizimin e transferimit ndërkombëtar në disa shtete pa nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe janë dhënë 2 vendime për lejimin e transferimit ndërkombëtar në disa sektorë, si bankat dhe në fushën farmaceutike.

Në përmbushje të detyrës për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, për vitin 2018, zyra e Komisionerit ka trajtuar 3 ankesa. Megjithëse ligji ka mbi 3 vjet që ka hyrë në fuqi, konstatojmë se ai nuk po zbatohet në nivelin e kërkuar nga organet publike, si dhe nuk po shërben si një mjet efektiv në dispozicion të qytetarëve.

Bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, zyra e Komisionerit ka detyrimin për të dhënë mendim për aktet normative, të cilat trajtojnë në përmbajtjen e tyre çështje ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë vitit 2018 janë dërguar për mendim 4 projektligje, 12 projektvendime të KM-së, 6 projekt marrëveshje të miratuara me VKM, 3 memorandume mirëkuptimi, 1 projekt-udhëzim, si dhe janë dhënë me dhjetëra opinione ligjore, si dhe kthim-përgjigje për kërkesat e paraqitura nga kontrolluesit publikë apo privatë.

Për sa i përket nivelit të zbatimit të rezolutës së Kuvendit të vitit 2017, ashtu siç e kemi raportuar edhe në Kuvend, zyra e Komisionerit si institucion i pavarur, i cili i nënshtrohet

detyrimin për raportim në Kuvendin e Shqipërisë, në funksion të zbatimit të vendimit nr. 49 të Kuvendit, por edhe të manualit të miratuar në fund të vitit të kaluar, zyra e komisionerit i ka realizuar plotësisht të gjitha rekomandimet e rezolutës së vitit 2017 të Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit.

Në fund dua të them dy fjalë për objektivat dhe vizionin e institucionit. Vizioni i zyrës së komisionerit është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale që, në fund të fundit, janë dy të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kjo do të realizohet nëpërmjet rritjes dhe ndërmjetësimit të publikut, bashkëpunimit me shoqërinë civile si partnere në garantimin e të drejtës për informim, konsolidimit të kuadrit ligjor, monitorimit lidhur me emërimin, ndryshimin e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre, monitorimit dhe përditësimit të programeve të transparencës dhe regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve dhe rritjen e numrit të hetimeve administrative, krijimin e një jurisprudence cilësore nëpërmjet vendimmarrjes së komisionerit, sepse është hera e parë që ne kemi një proces të tillë.

Gjithashtu, për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, është bërë përafrimi i legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave me Rregulloren e Bashkimit Europian dhe direktivën, që janë miratuar si paketë së fundmi, pra, Rregullorja e re e Përgjithshme e Bashkimit Europian, ngritja e kapaciteteve të stafit të zyrës së komisionerit, bashkëpunimi dhe partneriteti me homologët e shteteve anëtare të Bashkimit Europian, mbrojtja e të dhënave personale në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, kjo për shkak të zhvillimeve tejet të vrullshme teknologjike, njohja dhe ndërgjegjësimi i kontrolluesve publikë dhe privat me risitë e legjislacionit të ri të harmonizuar, edukimi i brezit të ri dhe fushata ndërgjegjësuese, qoftë në arsimin parauniversitar, qoftë në atë universitar, si dhe njohja e tyre me përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në sistemin dixhital.

Kjo ishte përmbledhja e raportit të zyrës së komisionerit për vitin 2018. Unë dhe bashkëpunëtorët e mi jemi në dispozicionin tuaj për çdo pyetje që mund të keni.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Dervishi!

Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

E falenderoj komisionerin për raportin vjetor, që pasqyron në vija të përgjithshme aktivitetin e institucionet, arritjet, problematikat e konstatuara, rekomandimet ligjore, analizën e punës për vitin 2018 dhe objektivat që ata kanë për vitin 2019!

Gjithashtu, dua ta përgëzoj zotin Dervishi për faktin se në këtë raport ne gjejmë një analizë krahasimore dhe analitike për mënyrën se si janë zbatuar rekomandimet e dhëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2017.

Ajo që vlen për t'u përmendur në vija të përgjithshme, pasi u përmend edhe nga vetë komisioneri, është se gjatë vitit 2018 konstatohet se është rritur niveli i transparencës për institucionet e pushtetit qendror. Gjithashtu, vihet re se zyra e komisionerit ka miratuar programin model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Njoftimi dhe konsultimi publik kanë qenë pjesë e veprimtarisë së punës së komisionerit. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave është krijuar Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në 27 autoritete publike. Janë rritur hetimet proaktive me iniciativë, çka ka qenë edhe në rekomandimin që është dhënë në rezolutë, për procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale. Ka tendencë në rritje për numrin e hetimeve pranë kontrolluesve të ndryshëm. Gjithashtu, zyra e komisionerit është angazhuar në organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për respektimin e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke studiuar edhe raportin, kam nxjerrë disa pyetje për Komisionerin, që besoj se do t'i shërbejnë edhe këtij raportimi.

Në faqen 42 të raportit të Komisionerit bëhet analiza e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Për sa i përket rekomandimit nr. 4, i cili ka qenë një rekomandim i ngritur dhe i dhënë nga zonja Hysi, dhe ka të bëjë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, a mund të na bëni një sqarim më të plotë për mënyrën se si ky rekomandim është realizuar nga ana juaj?

Pyetja e dytë. Nga raporti rezulton se Komisioneri, në zbatim të detyrës së tij, ka dhënë 29 rekomandime për vitin 2018. Dua të di, sa prej këtyre rekomandimeve janë dhënë për kontrolluesit publikë, pasi nuk bëhet një ndarje e qartë në raport?

Gjithashtu, nga raporti rezulton se 24 ankesa janë të mbartura nga viti 2018 në vitin 2019. Dua të di arsyet pse këto ankesa janë mbartur, pasi, me sa kam dijeni, afati për shqyrtimin e ankesave është 15 ditë. A jemi në tejkalim të afateve?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zoti Dervishi.

**Besnik Dervishi** – Për sa i përket rekomandimit nr. 4, ne kemi ndjekur detyrimet konkrete që, për sa u përket programeve të transparencës, se çfarë duhet të përmbajë një program transparence, është e përcaktuar në mënyrë të shprehur në nenin 7 të ligjit.



Në zbatim edhe të detyrimit që na buron nga rezoluta e Kuvendit, ne këtë e kemi harmonizuar edhe me detyrimet ndërkombëtare, pra e kemi parë në një këndvështrim më të zgjeruar, duke i orientuar autoritetet publike që të përfshijnë në programet e transparencës edhe detyrimet e tyre, që burojnë nga aktet e brendshme, por edhe nga aktet ndërkombëtare, siç është edhe rasti i rekomandimit që është lënë nga rezoluta e Kuvendit në pikën 4 të saj. Si është reflektuar kjo? Në qoftë se do të konsultoni atë që ne të paktën kemi pasur mundësi ta bëjmë gjatë vitit 2018 konkretisht, kjo është reflektuar shumë qartë në një kapitull të veçantë të programit të transparencës së organeve të vetëqeverisjes vendore, sepse ky ka qenë objektivi dhe që është realizuar për të pasur një program transparence të dedikuar për organet e vetëqeverisjes vendore.

Për vitin 2019 ne i kemi vënë vetes si objektiv që të punojmë në drejtim të institucioneve qendrore, të organeve të tyre të varësisë, por edhe të gjyqësorit në qoftë se do të bëhet e mundur edhe konsulenca ndërkombëtare, për të cilën natyrisht ne kemi nevojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes: sa rekomandime janë dhënë ndaj sektorit publik dhe atij privat, nga 29 rekomandime në total, 16 janë ndaj sektorit privat dhe 13 të tilla janë ndaj sektorit publik. Kuptohet që numri i kontrolluesve privatë është më i madh se atyre publikë. Ndaj, vëmendja e Komisionerit, natyrisht, pa lënë pas dore kontrolluesit publikë, ka qenë më e madhe ndaj kontrolluesve privatë, sepse nisur edhe nga ankesat që na vijnë në fushën e mbrojtjes së të dhënave, janë më tepër ndaj kontrolluesve privatë. Andaj, si të thuash, edhe ana e peshores anon nga kontrolluesit privatë.

Në raportimin e ankesave lidhur me të drejtën e informimit, ne kemi një fluks ankesash, që, siç e shikoni, është një numër i madh. 820 ankesa kanë qenë vetëm për vitin 2018, të cilat i kemi raportuar për precizion, sepse në përgjithësi ankesat te ne trajtohen brenda afateve.

Ka raste të veçanta, ku, edhe për shkak të kompleksitetit të çështjes, Zyra e Komisionerit, për shkak se nuk ka një praktikë, nuk ka një precedent të krijuar, por është një praktikë që po e krijojmë ne, në disa raste edhe ne kemi pasur nevojë. Një rast, për shembull, ka qenë në lidhje me vendimmarrjen për transparencë në procesin e vetingut, ku ne vërtet kemi marrë ndoshta pak më tepër kohë sesa ka parashikuar ligji, por mendoj se vendimmarrja ka qenë tejet pozitive dhe cilësore. Ndoshta rezultati më i mirë ka qenë që kjo vendimmarrje ka mbetur në fuqi dhe sot ka krijuar jurisprudencë në këtë drejtim. Por ne i respektojmë afatet.

Mund të jetë një përqindje, që në asnjë rast nuk e kalon 1% të rasteve, ku ne mund të kemi kaluar me shtyrje të afatit, siç e parashikon Kodi i Procedurave Administrative, por në asnjë rast jo më shumë sesa afati i parashikuar në ligjin specifik, që është 15 ditë. Pra, në rastet, ku mund të përfshihen te 1%-shi, kemi marrë edhe 15 ditë të tjera për shqyrtimin e rastit.

Për sa u përket 24 çështjeve të mbartura, ato janë çështje të depozituara në pesëmbëdhjetëshin e dytë të muajit dhjetor dhe, natyrisht, janë trajtuar në janar, por që llogariten si çështje të mbyllura në evidencën e vitit 2019, pastaj si çështje të mbyllura.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Dervishi!

Fjalën e ka zonja Hysi, e cila ka pyetje.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Dervishi, për raportin!

Me ju nis edhe sesioni i raportimeve të institucioneve të pavarura.

Kam lexuar me vëmendje kapitujt 1 dhe 2 të raportit tuaj dhe kam disa pyetje lidhur me monitorimin që i keni bërë ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Së pari, rritja e numrit të ankesave, që është relativisht i lartë në krahasim me një vit më parë, në vlerësimin tuaj, vjen si rrjedhojë e faktit që ligji “Për të drejtën e informimit” përmban standarde të larta në raport me kulturën dhe me mënyrën se si është organizuar administrata publike, apo ka të bëjë me sensibilizimin e pamjaftueshëm ose me ndërgjegjësimin e punonjësve që duhet ta zbatojnë ligjin “Për të drejtën e informimit”?

Së dyti, është shumë interesante analiza që ju i bëni programit të transparencës dhe shifra që ju thoni se 78 autoritete kanë publikuar regjistrin e kërkesë-përgjigjeve. Unë dua të di: sa është numri total i autoriteteve publike, të cilat kanë detyrimin të caktojnë koordinatoren për të drejtën e informimit dhe të publikojnë regjistrin e kërkesave, për të bërë edhe një analizë të përqindjes së këtyre institucioneve?

Pyetja e tretë lidhet me pjesën e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, e cila është jo vetëm pjesa më interesante, por do të thosha edhe shqetësuese. I shoh gjetjet tuaja nga inspektimet e kryera, qoftë *ex officio* ndaj kontrolluesve publikë dhe atyre privatë. Keni numërtuar këtu rreth 7 problematika, të cilat, me sa shoh, nuk janë probleme tipike shqiptare, por janë probleme, të cilat në vendet e Bashkimit Europian përbejnë një shqetësim. Edhe në këtë kuadër, do të doja, zoti kryetar, që në rezolutë të jemi të vëmendshëm, që shkeljet që ka konstatuar Komisioneri, të cilat i ka paraqitur në faqen 4 Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, pra mungesa e sigurisë së të dhënave personale, përpunimi i të dhënave në portale, përhapja në media, problemi i tejkalimit të afateve të mbajtjes së të dhënave

personale etj., (dhe këtu, kam një sugjerim, për të shmangur edhe atë fazën e diskutimit) Komisioni i Ligjeve dhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut të ndalet në mënyrë të veçantë për vitin 2019, duke pasur që kemi edhe një detyrim për ta përshtatur legjislacionin me direktivën e re të Bashkimit Europian, por, mbi të gjitha, kjo ka të bëjë drejtpërdrejtë me jetën e secilit prej nesh, kushdo qoftë. Ne që jemi në parlament, kemi detyrimin për të mbrojtur të dhënat personale nga çdolloj cenimi që mund të vijë qoftë nga kontrollues publikë dhe jopublikë. Shumë interesant është hetimi administrativ që ju keni bërë dhe gjobat që u keni vënë institucioneve përgjegjëse lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale. Pra, keni 30 vendime gjobash ose 61 sanksione administrative. A keni ndonjë rezultat ose ndjekje të zbatimit të punës në këto ministri? Pra, dakord vënia e gjobave, por a keni vënë re dhe a u jeni rikthyer përsëri institucioneve për të parë ndonjë përmirësim të metodologjisë së mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave, apo situata është thjesht 61 sanksione administrative dhe asgjë tjetër?

E fundit fare, shoh një koment tuajin lidhur me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik. Besoj se ky ligj është një ligj i ri, i avancuar, është një nga më të avancuarit në nivel europian dhe ju thoni se nuk zbatohet në nivelin e kërkuar nga organet publike. Shkakun e moszbatimit të ligjit e lidhni me periudhat e shkurtra që ne i kemi lënë në afatet e konsultimit publik apo me mosndjeshmërinë që mund të kenë punonjës të veçantë për ta zbatuar fazën e konsultimit publik, apo keni konstatuar që konsultimi bëhet, por nuk u jepen përgjigje palëve të konsultuara lidhur me marrjen ose jo në konsideratë të rekomandimeve të tyre?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Dervishi.

**Besnik Devishi** – Për sa i përket rritjes së numrit të ankesave, që nga viti i kaluar është konstatuar një efekt pozitiv, pra numri i ankesave të kërkuara nga qytetarët drejtpërdrejt ka qenë më i madh se sa i atyre të organizatave të shoqërisë civile, sepse unë e kam bërë të qartë edhe në raportimet e mëparshme që me miratimin e ligjit që në vitin e tij të parë kanë qenë 24 projekte të shoqërisë civile, që ndiqnin zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Natyrisht, dy vjetët e parë numri i ankesave të dërguara nga shoqëria civile ka qenë më i madh se ai i qytetarëve. Vitin e kaluar për herë të parë numri i ankesave të qytetarëve ishte më i madh, kurse për vitin 2018 numri i ankesave është rritur jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi nga 560 që ishte në vitin 2017, ka vajtur në 820 në vitin 2018. Vazhdon trendi, pra mbi 60% e ankesave janë të dërguara nga qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo nga organizatat e shoqërisë civile. Pra, pavarësisht se nuk ka një rënie të aktivitetit të organizatave të shoqërisë civile, ka

një rritje të angazhimit të qytetarëve. Kjo ka ardhur në radhë të parë jo si çështje e rritjes së mungesës së transparencës nga ana e autoriteteve publike. Duhet të themi se ka një përmirësim të transparencës së autoriteteve publike, por ndërgjegjësimi i qytetarëve është në një nivel shumë më të lartë, në krahasim me çfarë ka qenë disa vjet më parë. Kjo ka të bëjë me faktin që ligji është shumë më i mirë. Jo më kot ligji që ne kemi në fuqi vlerësohet i gjashti në botë. Instrumentet që i ka dhënë ligji në dorë qytetarit, por edhe organit ku qytetarët kanë të drejtë të ankohen, që është Zyra e Komisionerit, kanë bërë që të rritet besimi qoftë në proces, qoftë edhe tek institucioni që shprehet në fund.

Natyrisht që ju e patë se unë në raport kam vënë edhe një numër ankesash që kanë ardhur te ne, të cilat janë jashtë objektit të ligjit. Sido që të jetë, bazuar në Kodin e Procedurës Administrative, pavarësisht se kemi të bëjmë me çështje jashtë objektit të ligjit, për shembull kur kanë lidhje me regjistrimet në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sepse nuk është një proces informimi, ose me çështjet personale të praktikave personale që kanë qytetarët tek ALUIZNI, ose për çështjet e masës së pensionit të sigurimit shoqërorë, ne jemi përpjekur t'i orientojmë dhe i kemi orientuar nëpërmjet mekanizmave që kemi në dispozicion nëpërmjet koordinatorit, ku i kemi deleguar tek autoritetet publike përkatëse, sepse edhe këto çështje janë jashtë objektit të ligjit për të drejtën e informimit.

Sa janë autoritetet publike? Këtu edhe për shkak të ndryshimeve strukturore, veçanërisht në ekzekutiv, por edhe të reformës që u bë në organet e vetëqeverisjes vendore numri është ulur nga sa ishte në fillim dhe sot ne kemi rreth 400 autoritete publike efektive. Natyrisht, jo të gjitha këto mund të konsiderohen nga pikëpamja formale e ligjit autoritete publike, por jo të gjitha kanë aktivitet për ta bërë atë publik, ose disa prej tyre janë aq të vogla, saqë nuk kanë mundësi për të pasur qoftë faqe interneti, qoftë edhe për të pasur programe transparence të dedikuara. Gjithashtu, ne jemi përpjekur të bëjmë edhe një organizim nëpërmjet udhëzuesi që e kemi hartuar ne, por natyrisht që nuk është detyrues për autoritetet publike, sepse ndoshta një nga defektet e pakta që mund të ketë ligji është që Komisioneri nuk ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të ligjit. Për shembull, marrim drejtoritë e përgjithshme, të cilat kanë edhe degë rajonale. Do të quhen autoritete publike, në kuptim të ligjit, vetëm drejtoritë përgjithshme në Tiranë apo edhe degët e tyre rajonale. Për shembull, ne kemi ndjekur një politikë të tillë që, për shkak të rëndësisë, të 13-ta DAR-et e shtrira në të gjithë territorin e vendit, i kemi quajtur autoritete publike, por nuk kemi ndjekur të njëjtën praktikë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku jemi përpjekur të përqendrohet në Drejtorinë e Përgjithshme koordinatori dhe të ngrihet brenda autoritetit publik rrjeti i

koordinatorëve ose i ndihmëskordinatorëve në të gjitha degët rajonale të tatimeve. Pra, këtë jemi përpjekur ta zgjidhim nëpërmjet një udhëzuesi të hartuar nga Zyra e Komisionerit.

Ju bëtë një pyetje, që unë mendoj se thelbi i saj qëndron te portalet, sepse shpeshherë na vijnë ankesa, të cilat janë në rritje ndaj keqpërdorimit ose përdorimit jo të ligjshëm të të dhënave personale në portale. Ajo që mund të bëjë Zyra e Komisionerit është shumë e kufizuar, sepse nuk ka një ligj bazë që rregullon aktivitetin e portaleve. Ne kemi pasur raste flagrante, ku kemi arritur të identifikojmë portalet, por ka raste që janë edhe të paidentifikueshme, nuk janë të regjistruara në territorin shqiptar, por janë të regjistruara jashtë vendit dhe as ne dhe as AKEP-i, me të cilin kemi një bashkëpunim shumë të mirë, nuk kemi juridiksion që t'i kapim. Kështu që kjo është një problematikë shumë e madhe dhe hartimi i një legjislacioni të plotë, për sa i përket administrimit të portaleve, do ta ndihmonte shumë mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa u përket sanksioneve që vendos Zyra e Komisionerit, ne e kemi shprehur edhe në raport, por është edhe një detyrim që buron nga vendimi nr.49 dhe manuali i hartuar në zbatim të tij, dhe kemi krijuar një praktikë të mirë të konsoliduar prej tre vjetësh. Të gjitha rekomandimet që dalin gjatë një viti kalendarik, ne i verifikojmë zbatueshmëritë e tyre në distancë, 6 muaj deri në një vit, duke iu referuar edhe afateve që ne vendosim vetë ndaj kontrolluesit për zbatimin e detyrimeve që ne lëmë për të plotësuar në rekomandim. Ne kemi vendosur sanksione për disa organe të qeverisjes vendore, kanë qenë në zbatim të një rekomandimi që u kemi lënë atyre në vitin 2016 dhe natyrisht u dhamë të gjithë kohën e nevojshme, duke qenë se viti 2017 ishte vit zgjedhësh, dhe në 6-mujorin e dytë të vitit 2018 ne kemi verifikuar zbatimin e rekomandimeve të lëna ndaj këtyre organeve në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale. Jo të gjithë e kishin zbatuar, kishte bashki të mëdha, të cilat e ngatërronin mbrojtjen e të dhënave personale me koordinatorin e të drejtës për informim, që është diçka tjetër. Ndoshta është pozitive që përgjegjës të jetë i njëjti, sepse specializohet qoftë për të drejtën e informimit, qoftë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe pikë referimi ka vetëm një institucion, por nuk është e pranueshme që të mos e dimë që ka detyrime të tjera, që burojnë nga e drejta për informim, dhe detyrime të tjera për garantimin e një të drejtë tjetër, siç është mbrojtja e të dhënave personale.

Për sa i përket ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik, unë e thashë që nuk është detyra jonë, sepse detyrën kryesore për monitorimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik e ka qeveria dhe ministri përgjegjës për teknologjinë e informacionit, siç është vetë përkufizimi i ligjit, por Zyrës së Komisionerit i është lënë detyrë trajtimi i ankesave kur akti është miratuar. E thashë që për vitin 2018 ne kemi pasur vetëm tri ankesa, por ajo që ne

konstatohet për ecurinë jo të mirë të këtij ligji lidhet me të drejtën e informimit, sepse shpeshherë, duke u mbështetur edhe te ligji për të drejtën e informimit, qytetarë të ndryshëm, ose organizata të shoqërisë civile kërkojnë informacion për zbatimin e procedurave ose moszbatimin e procedurave që parashikon ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Nga analiza e këtij fenomeni ne kemi konstatuar që procedurat dhe zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik ndoshta nuk është në nivelin e duhur. Gjithashtu, kjo lidhet edhe me një raportim që bëhet në kuadër të projektit të fuqizimit të administratës publike, ku është vlerësuar nga donatorët që zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit është në nivelin 86%, ndërsa zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik është në një nivel ende të ulët.

Ne kemi bërë një propozim para komisionit, që ndoshta duhet parë, sepse na

ka ardhur edhe si ndjesi e shoqërisë civile, ku monitorimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik t'i kalohet një institucioni të pavarur, pse jo Zyrës së Komisionerit, sepse në praktikën ndërkombëtare ligji për të drejtën e informimit dhe ligji për njoftimin dhe konsultimin publik konsiderohen si dy ligje *sunshine law*, si dy ligje që ndriçojnë skutat e errëta të administratës publike dhe ndoshta unifikimi i praktikës në një institucion të vetëm mund të ishte diçka pozitive, ku Zyra e Komisionerit mund ta ofrojë këtë mënyrë të re pune, që mund të jetë edhe një sfidë e re për ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik.

**Ulsi Manja** – Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Unë kam një shqetësim në lidhje me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik. Në faqen numër 23 të raportit tuaj shoh që ka pasur vetëm tri ankesa, dy nga bashkitë dhe një nga institucioni i administratës qendrore, ku thoni se edhe pse ligji ka mbi 3 vjet që ka hyrë në fuqi, ai nuk po zbatohet në nivelin e kërkuar nga organet publike, si dhe nuk po shërben si një mjet efektiv për qytetarët, por unë mbaj mend se në vitin 2014, periudha që i paraprinte miratimit të ligjit, ka qenë një periudhë shumë aktive, sepse i gjithë qëllimi i normimit të një shtate të njoftimit dhe konsultimit publik lindi si nevojë e përfshirjes së publikut në vendimmarrje. Kjo ka qenë një kërkesë e organizatave të shoqërisë civile, që grupet e interesit të përfshiheshin në momentin e hartimit të ligjit, në momentin e shqyrtimit të tij dhe në të gjitha hallkat e vendimmarrjes nga organet publike. E parë në këtë këndvështrim, do të duhet që të mos jetë vetëm shteti ai që bën detyrat e veta, në kuptimin e njoftimit, por të jetë një angazhim më i thellë, më aktiv dhe më efektiv i shoqërisë civile për të qenë pjesëmarrëse në këto procese, duke përdorur mekanizmat që i ka dhënë ligji, që të ngrejë shqetësimet e qytetarëve, të cilat adresohen në çështjet që janë pjesë e vendimmarrjes publike.

Sipas analizës së raportit tuaj, i cili ka vetëm tri ankesa, mund të nënkuptojmë se ligji ka funksionuar mirë, e nuk ka ankesa nga grupet e interesit dhe mund të jetë një indikator që

ligji qenka zbatuar mirë dhe ka qenë efektiv, ose mund të bëhet analiza, në këndvështrim të atyre që ju po shpjegoni, që ligji ka pasur problemet e veta, sepse nuk është përdorur nga grupet e interesit, por edhe nga mungesa e eksperiencës që kanë organet shtetërore për të zbatuar dispozitat e tij. A ka ardhur koha që ta rishohim këtë pjesë të ligjit, jo vetëm sa i takon monitorimit, por edhe për të diskutuar në lidhje me normimin, siç ndodh në të gjitha vendet e Europës dhe në Parlamentin European, e procedurave, në lidhje me grupet e interesit që duhet të regjistrohen, të akreditohen, të kenë një lloj statusi në shoqëri, në mënyrë që në çdo proces të kemi një grup të caktuar, i cili është i detyrueshëm që të jetë pjesë e vendimmarrjes dhe të ketë një detyrim të dyanshëm të atyre që janë pjesë e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, por edhe të organeve shtetërore për të zbatuar një detyrim të tillë me mekanizma efektivë ligjorë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni, zoti Dervishi!

**Besnik Dervishi** – Unë e përmenda pak më parë ky nuk është një ligj që ngarkon si dy ligjet e tjera drejtpërdrejt Zyrën e Komisionerit. Ne kemi vetëm një funksion të caktuar në procesin përfundimtar të tij, por opinioni ynë ka dalë si rezultat i analizës që ne i kemi bërë këtij procesi për shkak të ankesave të shumta që na kanë ardhur, duke iu referuar ligjit “Për të drejtën e informimit”. Për shembull, shumë grupe interesi ose organizata të shoqërisë civile janë drejtuar, duke shfrytëzuar instrumentin e së drejtës për informim, për procese të konsultimit publik, që sipas tyre nuk janë kryer në mënyrën e duhur, duke respektuar afatet dhe procedurat e përcaktuara në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Kjo është ndjesia jonë dhe ne këtë kemi bërë prezent.

Ne nuk e kemi as të drejtën dhe as detyrën që të monitorojmë nëse janë zbatuar procedurat e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, apo jo? Ashtu siç e thatë edhe ju, di që në fillim është bërë një punë shumë e mirë, siç ka pasur projekte të shoqërisë civile për ligjin “Për të drejtën e informimit”, ka pasur edhe për ligjin tjetër, pra është krijuar regjistri pranë AKSHI-t, ku duhet të hidhen dhe të depozitohen, nga të gjitha organet propozuese, veçanërisht ministritë, të gjitha aktet normative, por edhe kategoritë e tjera të akteve, të cilat duhet t'i nënshtrohen njoftimit dhe konsultimit publik, por ne nuk e kemi të drejtë që ta monitorojmë, siç është zbatimi i kësaj, sepse, ju thashë ligji ngarkon, si organ përgjegjës ministrin që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit.

Për atë që kemi qenë ne të angazhuar, ka pasur një ministër Shteti për Teknologjinë e Informacionit të dedikuar, ne kemi qenë pjesë gati e të gjitha grupeve të punës që funksiononin

pranë tij, madje kemi dhënë edhe kontributin tonë. Ndoshta, për shkak të organizimeve të reja, ka humbur pak, ashtu siç thatë edhe ju ndoshta kërkon një organizim të ri. Por ky nuk është opinioni i Zyrës së Komisionerit, sepse ne nuk mund ta vlerësojmë ecurinë e vetë ligjit, ne mund të konstatojmë vetëm problematikat për shkak të ankesave që na vijnë, referuar të drejtës për informimin për procedurat e ndjekura gjatë këtij ligji. Në këtë këndvështrim ndoshta ka nevojë për një përmirësim, që pse jo edhe ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” të jetë zbatueshmëria e tij në nivelet e ligjit “Për të drejtën e informimit”.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Dervishi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë kam unë një pyetje, përpara se të kalojmë në diskutime.

Zoti Dervishi, në raportin e përmbledhur që ka bërë Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, në faqen 4 thuhet se janë zhvilluar 108 inspektive në terren, 45 subjekte kontrollues publike, 63 kontrollues privatë, keni zhvilluar edhe 28 inspektive mbi bazë ankesash kryesisht për cenimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, për mungesë të sigurisë së të dhënave dhe për përpunimin e të dhënave në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme për hapjen e medieve dhe portaleve *online*. Kam një pyetje të drejtpërdrejtë: në 28 inspektive që keni zhvilluar mbi bazë ankesash, kryesisht për portalet dhe mediet *online* të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, a keni konstatuar shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe çfarë masash janë marrë konkretisht? Nëse do të ishte e mundur (nuk i shikoj në raport), na sillni edhe të cituara me emërtimin përkatës se cilat janë mediet dhe portalet *online*, gjithmonë nëse në 28 inspektive që ju keni bërë, keni konstatuar shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

**Besnik Dervishi** - Natyrisht, e administrova kërkesën tuaj dhe informacionin e detajuar do t’ju dërgojmë menjëherë për të gjitha portalet që është paraqitur ankesë ndaj Zyrës së Komisionerit, gjithashtu edhe për masat konkrete që ka marrë Zyra e Komisionerit. Mund t’ju përmend rastin e fundit që kemi pasur, në një rast, që ne na është deleguar nga autoriteti italian i mbrojtjes së të dhënave, ku në një rast që është një lajm, që lidhej me ngjarje të ndodhur në Jalë, në qoftë se e keni parasysh pati një përplasje midis INUK-ut që po zbatonte një vendim për disa prishje, por pati edhe një ngarkesë politike me një deputet. Emri i personit të përmendur në të gjitha portalet ishte i njëjtë me një person shqiptar që kishte emigruar në vitin ’91 në Itali, por që kishte shtetësinë italiane. Portalet duke klikuar nuk kishin marrë fotografinë e personit, të nëpunësit, që ishte subjekti i ngjarjes në Jalë, por të këtij qytetari italian tashmë dhe në të gjithë portalet kishte dalë fotografia e tij. Ai, nëpërmjet avokatit, kishte bërë ankesën në autoritetin italian të mbrojtjes së të dhënave dhe ata na i përcollën për kompetencë. Ata kishin



sjellë disa prova, ne e thelluam hetimin, verifikuam lajmin dhe verifikuam të gjitha portalet. Në mos gaboj në tri portale, që ishin të regjistruara dhe të identifikuara, ne dërguam menjëherë njoftimin dhe urdhrin për fshirjen e të dhënave personale, të cilat ishin përpunuar në mënyrë jo të ligjshme, portalet reagues menjëherë, duke e korrigjuar këtë gabim të bërë, por me sa mbaj mend, ishte edhe një portal “Shkodra news”, që nuk ia gjenim regjistrimin, madje kërkua edhe bashkëpunimin e AKEP-it. AKEP-i na ktheu se nuk figuron i regjistruar. Megjithatë, unë mund të dërgoj, në qoftë se kjo gjë është me interes për ju. Ne përgatisim në detaje një informacion dhe jua dërgojmë. Unë jua përmenda që është problematikë për sa i përket verifikimit, sepse nuk ka një ligj bazë ku ne të mbështetemi për mbrojtjen dhe garantimin e një të drejte dhe lirie themelore, siç është edhe mbrojtja e të dhënave personale.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Dervishi!

Në fakt, do të ishte me interes ardhja e një raporti të tillë analitik për Komisionin e Ligjeve, posaçërisht për t’u trajtuar edhe në Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut pranë Komisionit të Ligjeve. Do të ishte mirë që ky raport të vinte para se ne të miratonim rezolutën për institucionin që ju drejtoni në seancë plenare.

**Besnik Dervishi** – Patjetër.

**Ulsi Manja** – Nuk besoj se ka pyetje dhe diskutime të tjera nga kolegët.

Faleminderit, zoti Dervishi, për ekspozenë tuaj në Komisionin e Ligjeve për veprimtarinë e institucionit që ju drejtoni!

Si përherë, ishit i saktë, transparentë, por edhe korrekt për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Dua të falënderoj edhe kolegët e mi për seriozitetin dhe trajtimin e kësaj dëgjese publike me komisionierin, zotin Dervishi!

Nga relatorja dhe kolegët e mi do të kërkoja të tregojnë të njëjtën gatishmëri edhe për tekstin e projektrezolutës që u është shpërndarë. Keni në dispozicion nga relatorja projektrezolutën e vitit 2018. Sot në këtë seancë dëgjimore, por edhe në raportin që zoti Dervishi ka depozituar në komision janë trajtuar gjerësisht dhe në mënyrë analitike zbatimi i të gjitha rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit dhe do të ishte mirë që, së bashku me raportin, që do ta sjellë komisionieri për atë që sapo u tha, të arrijmë në tekstin e një rezolute të saktë, të qartë dhe të integruar, ku të reflektojnë edhe shqetësimet për mbrojtjen e të dhënave personale, jo vetëm nga autoritetet publike, por edhe private.

Faleminderit, zoti Dervishi!

Faleminderit, kolegë!

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria.

Ditë të mbarë!